



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:305177

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05831307

2023:305178

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshem, Divizioni penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me sekretaren juridike Indira Beqa, në çështjen penale ndaj të pandehurit B.D nga fsh....-Kaçanik, për veprën penale, Vjedhje e sherbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-se , sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr. 1681/23 të datës 28.12.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.13 qershor 2024 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Egzon Jakupi, përfaqësueses së të dëmtuarës T.K dhe të pandehurit, me dt.18 qershor 2024 mori dhe shpalli dhe të njejten datë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri B.D nga fsh....-Kaçanik , i lindur më dt.... , nga i ati Q... dhe e ema H... , e gjinisë M..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves, i martuar prind i shtatë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, shfrytëzues i ndihmës sociale, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal:

ËSHTË FAJTOR

Sepse nga data e pa vërtetuar e deri me datë 10 tetor të vitit 2022, në fshatin ...-Kaçanik, në shtëpinë e tij familjare ku edhe banon, i pandehuri në cilësi të shfrytëzuesit, siguron shërbime të energjisë elektrike për të cilat e din se mundësohen vetëm me anë të pagesës dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, në atë mënyrë që gjatë kontrolli të bërë nga ekipi i kompanisë “KEDS”, rezulton se i pandehuri ka bere lidhje direkte jashtë pikës matëse ku përmes nje faze ka furnizuar shtëpinë me energji elektrike, duke e anashkaluar njehsorin elektrik me numër ..., ku energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç’ rast të dëmtuarës ndërmarrjes “KEDS”, Distrikti në Ferizaj, i ka shkaktuar dëm material.

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,7,38,43,69,70 dhe 71 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-se, si dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me denim me gjobë në shumë prej 200.00 € (dyqind euro), I cili denim konfor nenit 43 par.5 te KPRK-se , i zëvendësohet me pune ne dobi te përgjithshme ne kohëzgjatje prej 90 orëve.

Puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet brenda afatit prej 1 viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën gjykata do të urdhëroje denimin me burgim ashtu që për çdo 8 orë pune do të llogaritet një ditë burgimi.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaje pranë kësaj gjykate shumën prej 20.00 € , derisa per Fondin për Kompensimin e Viktimave te Krimit shumën prej 20.00 €, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara- KEDS-Distrikti në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në contest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr. 1681/23 të datës 28.12.2023, të pandehurin B.D e ka akuzuar për veprën penale, Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së , dhe ka kërkuar që i njejtë të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Në bazë të kësaj aktakuze, gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.13 qershor 2024 me të cilin rast, prokurori I shtetit Egzon Jakupi deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotësime.

I pandehuri në fjalën e tij në shqyrtimin fillestar, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza dhe shton se për shkak të kushteve jo të mira ekonomike, pasi që jeton me asistencë sociale, I është akumuluar borgji në KEDS , dhe në pamundësi që të paguajë këtë borgj ndaj të dëmtuarës, ka qenë I detyruar që të lidhet direkt në rrjetin elektrik jashtë pikes matëse. I njejtë poashtu thekson se normalisht që nuk e ndien veten mirë për veprimin e tij dhe I premtonte gjykatës se veprime të tilla nuk do të përsërisë në të ardhmen, dhe duke qenë se nuk është përsëritës I kësaj vepre penale, njëherit i kërkon gjykatës që më rastin marrjes së vendimit t'i shqiptohet një dënim sa më I ulët që të jetë e mundur.

Prokurori I shtetit dhe përfaqësuesja e të dëmtuarës në fjalën e tyre janë dakorduar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 të KPP pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht , se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese konform nenit 70 të KPRK-se, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në

shqyrtimin fillestar, ka premtuar para gjykatës se veprime te tilla do te mundohet që të mos përsërisë më në të ardhmen, bazuar në evidencën e gjykatës I njejti nuk është përsëritës I kësaj apo veprave tjera penale, jeton në kushte të dobëta ekonomike, gjegjësisht me asistencë sociale, ndërsa rrethanë të posaqme rënduese Gjykata nuk gjeti përveq veprimeve të të pandehurit të cilat paraqesin elemente të veprës penale, për të cilën është shpallur fajtor.

Andaj gjykata, për këto arsye te pandehurin B.D I akuzuar për veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv të ketij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është ne proporcion me veprën si dhe sjelljen e te pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura, personalitetin e te pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do te ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë qe te mos kryejnë vepra te tilla penale dhe se me ketë do te arrihet ne tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 te KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 te Ligjit për Kompensimin e Viktimave te Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore jurididike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

2023: 305177 datë 18.06.2024

Sekretarja Juridike,

Indira Beqa

Gjyqtarja,

Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër ketij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.